



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 71-të, të mbajtur më 30.06.2022, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-3576/1 të datës 14.10.2020, HIDHET POSHTË.

Denoncimi i lëndës me pretendime ndaj personit të punësuar në MPB të SPB-së Kumanovë të dorëzohet për veprim kompetent në Departamentit për kontroll të brendshëm, hetime kriminale dhe standarde profesionale të MPB-së. të RMV-së.

Lënda me numër 12 –2053/1 të datës 31.05.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur u dorëzua denoncim të regjistruar me numër 12-3576/1 të datës 14.10.2020 me pretendime ndaj personave të punësuar në MPB, SPB, Kumanovë. Në rastin konkret pretendimet janë kundër personave ----- dhe -----, i cili si kryetar dhe anëtar i komisionit disiplinor të SPB Kumanovë ka vepruar me propozimin për iniciimin e procedurës për konstatimin e përgjegjësisë për shkelje të rendit të punës dhe disiplinës ndaj parashtruesit të denoncimit, me numër ----- të datës 21.09.2020 dhe më datë 02.10.2020 është zhvilluar diskutim, nga e cila është përgatitur Procesverbali me numër: ----- të datës 02.10.2020. parashtruesi konsideron se personat e denoncuar kanë qenë në situatë konflikti interesash dhe e kanë zhvilluar procedurën në mënyrë të njëanshme, gjegjësisht se kanë qenë të detyruar të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ndikimin e interesit privat dhe për të informuar udhëheqësin e tyre.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit në fjalë, KSHPK-ja konstaton se pretendimet në denoncim i referohen veprimeve të personave të autorizuar në MPB në zhvillimin e procedurës disiplinore, për të cilat KSHPK-ja nuk ka kompetencë të veprojë. Prandaj, KSHPK-ja vendosi që kërkesën për veprim kompetent ta dorëzojë në Departamentin për Kontroll të Brendshëm, Hetime Kriminale dhe Standarde Profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV-së.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij Vendimi.

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЁ  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Нёнкрыетар  
Нури Бајрами

Пёргатити: J.C.  
Миратои: Mr.VG, анётар и KSHPK-сё

